




DPK/DMP  
02

03-3872/13  
14.11.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

Nr.476-05/2012

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Divizioni për Kundërvajtje**, me gjyqtarin **Gjimshit Galushi**, dhe procesmbajtësen **Nexhla Vebiqi** në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehures **Lulije Buzhala nga Prizreni**, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5. dhe 6. par.1.3 .si dhe neni 9, të ndëshkuar sipas neni 17.par.1.3 të **Ligjit për Deklarim, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, e në bazë të neni 195 të **LMK-së**, me datën **11.10.2013** merr këtë :

**A K T V E N D I M**

**E pandehura Lulije Durmish Buzhala, e lindur me 24. 10. 1960, në fsh. Gelancë KK Suharekë, me vendbanim në Prizren, rruga Tefik Qanga nr.102.**

**Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s e**

**Sepse**, sipas kërkesës së Agjencionit, e si Zyrtare e lartë publik – deputete në asamble komunale në Prizren, nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë dhe prejardhjen e saj, pranë Agjencisë kundër Korrupsionit - brenda afatit Ligjor (**deri më 31.03.2012**), edhe pse ka qenë i obliguar,

- me kete veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5. dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas neni 17.par.1.3 të **Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, e për këtë, duke aplikuar nenin 9 të **LMK-së**.

**D E N O H E T**

**Me gjobë në lartësi prej 350 ( treqind e pesëdhjetë )Euro .**

E pandehura obligohet që denimin e shqiptuar me gjobë, ta paguajë në afat prej **15 ditëve**, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktvendimi. Poqese këtë nuk e bën në afatin e caktuar, atëherë gjoba e shqiptuar do të zavendsohet me burgim, duke llogaritur **20 euro për një ditë burgu**, kurse në afatin e njejtë në emër të shpenzimeve gjyqësore, do të paguajë shumë prej **5 (pesë) euro**, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

Sipas kërkeses së Agjencisë kundër Korupsionit të Republikës së Kosovës - në Prishtinë , me nr.01-1891-2012 të datës 24.05.2012 , u zhvillua procedura kundërvajtëse kundër të pandehures lartëcekur , për shkak të kundërvajtjes nga neni 5. dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas nenit 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik .

Gjendja faktike është vërtetuar në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës , si dhe deklaratës së të pandehures , e cila në deklaratën e saj ka theksuar se është e vërtet që deklarin e pasurisë e ka bërë pak me vonesë ,pasi që edhe njoftimin-formularin për deklarin e ka marur me vonesë të cilën pastaj e ka plotësuar, dhe me datën 13.07.2012 e ka dorëzuar Agjencionit kundër korupsionit të Republikës së Kosovës.

Nga të dhënat e parashtruar në kërkesë , vlerësimi të deklaratës së të pandehures , si dhe vlerësimi të të gjitha provave së bashku dhe secilës veç e veç të bashkangjitura në kërkesë , Gjykata konstatoi se me datën 13.07.2012 e pandehuri me të vërtet kishte plotsuar , por edhe ka dorëzuar formularin mbi deklarin e pasurisë në Agjencinë kundër korupsionit.

Duke pasur parasysh rethanat nga neni 7 të LMK-së , se e njejta ka patur sjelljet korekte , e poashtu faktin se me vonesë është njoftuar me formularin mbi deklarin e pasurisë se nga afati ligjorë për deklarin e pasurisë kanë kaluar disa muaj, mirpo egziston fakti se e pandehura në fjal edhe pse me vonesë , e ka përmbush obligimin e vet, gjykata është qëndrimin se në veprimet e të pandehures egzistojnë elementet e veprës së kundërvajtjes nga dispozitat e shenuara më lartë , e duke aplikuar nenin 9 të LMK-së , e ka zbutur denimin , duke patur parasysh sjelljen e saj ekonomike , se deklarin me vonesë ka bër nga mos njoftimi me kohë nga ana organit kompetent , me bindje se edhe me këtë llojë të denimit do të arihet qëllimi i ndëshkimit , që e njejta në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme , dhe të respektoj afatin ligjorë .

Vendimi mbi shpenzimet gjyqsore është marrë konform nenit 109.2 të LMK-së .

Me sa u cek me larte, u vendos si ne dispozitiv te aktvendimit .

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Divizioni për Kundërvajtje**  
Nr.476-05/2012, datë: 11.10.2013

Gjyqtari  
Gjimshir Galushi

**UDHËZIMI JURIDIK** : Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur , mund të ushtrojë ankesë , Gjykatës së Apelit - Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditëve , pas marrjes të të njejtit , përmes kësaj Gjykate .